

## STATUT

### **I SHOQËRISE KEP MERLI 1 SHPK**

Sot ne dt.06 Korrik 2021 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

**EROS SHËNEDIELA**, i biri i Agim, i datelindjes 22/04/1990, i lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr.Ibrahim Rugova, kompleksi Green Park, kulla e pare, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. 036516453 ,leshuar nga MB me date 14/10/2020, i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **KEP MERLI 1** shpk.

#### KREU I

#### Krijimi, Personaliteti juridik, Selia

##### Neni 1

##### Krijimi

Shoqeria **KEP MERLI 1** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

##### Neni 2

##### Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **KEP MERLI 1** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

#### **Shoqeria e ka seline ne adresen:**

#### **Ksamil, fshati turistik Kep Merli, zona kadastrale 2297.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

##### Neni 4

#### **Objekti i veprimtarise**

- **Sherbime ne fushen e hotelerise, Bar-Restorant-Plazh, sherbime turistike, operator turistik, agjensi turistike, agjensi udhetimesh turistike, marrje dhe dhenie me qira hotele dhe dhoma per qellime turistike, dhenie me qera e automjeteve dhe çdo sherbim tjetër ne fushen e turizmit.**
- **Ndertime te objekteve civile dhe industriale. Projektimi dhe zbatimi per ndertimin e objekteve te ndryshme si dhe te ndertimeve civile industriale, turistike, bujqesore dhe kompletimi me instalime te nevojshme me tuba betoni si dhe ata elektrike, hidraulike, sistemeve te ngrohjes, ujsjellesa, kanalizime, hapje trasesh te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit, ndertim rruges, asfaltime etj. Sherbime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit. Prodhim i materialeve te ndryshme betoni.**



- **Perfaqesime kompanish te ndryshme nderkombetare,eskuzivitete apo ndermjetesime kompanish nderkombetare, ne fusha te prodhimit, tregtimit apo sherbimeve te ndryshme.**
- **Sherbime konsulence per investitoret,planifiki, projektim dhe realizim i projekteve Industriale,Energjitike,Turistike e Bujqesore.**

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500.000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 500.000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise **EROS SHËNEDIELA.**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **500.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit prej **500.000 Leke** do te paguhet ne te ardhmen nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar to shoqerise. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve to kapitalit qe perfaqesojne.

Vendimi lidhur me kapitalin i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga administratori ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 03.5.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me pelqimin e Ortakut te Vetem Themelues te shoqerise. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve.Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve



KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9  
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.  
Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.  
Asambleja e Ortakut te vetem eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i Ortakut te Vetem Themelues ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Asambleja e ortakeve mund te thirret nga Ortaku i vetem themelues,nga administratori,nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesi.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 10  
Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakut te vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11  
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

**EROS SHËNEDIELA**, i biri i Agim, i datelindjes 22/04/1990, i lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr.Ibrahim Rugova,kompleksi Green Park,kulla e pare, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. 036516453 ,leshuar nga MB me date 14/10/2020.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te



parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata per shkeje te ligjit me kerkese te Ortakut te Vetem Themelues. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

## Neni 12 Kompetencat

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asambleja e Ortakut te vetem.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.


Administratorit ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje to gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojte shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullit te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportoje perpara Asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve to ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo to huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha



shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per to kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave to Punes, Autoriteteve Doganore etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

### Neni 13

#### Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin deme shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 to ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" administratori detyrohet:

1.

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me te kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne te, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara nese ne kundersiztim me dispozitat e ligjit , Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) a paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet e shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per to shlyer detyrimet
- e) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.



Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### Neni 14

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 15

##### Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 16

##### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e Ortakut te vetem, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

#### Neni 18

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakut te Vetem Themelues të shoqerise.

#### Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

- a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 20

##### Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.



Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së shoqërise në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

#### Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqëria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debitore qe shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

#### Neni 23

##### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqërite tregtare", Kodit Civil, Ligjin per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 24

##### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

#### Neni 25

##### Dispozita perfundimtare

Ky statut hartohet dhe nenshkruhet ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërise tregtare **KEP MERLI 1** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

Eros Shënediale

